

AKT-THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ALBKET” shpk

Sot, më datë 12/02/2025 hartohet Akti i Themelimit i Shoqërisë

“ALBKET” shpk

Me anë të këtij dokumenti, të hartuar në 4 (katër) kopje origjinale, ortakët e shoqërisë:

1. Ortaku Bekim PIREVA, i lindur në Prishtinë (Kosovë) më 09.05.1981, banues në Rrugën Justina Shkupi Nr.68 Prishtinë, shtetas Kosovar, i identifikuar me Pasaportën nr. P02788548;

2.. Ortaku Gentian CANI, i lindur në Tiranë më 17.12.191972, shtetas Shqiptar, i identifikuar me Kartën e Identitetit nr.H21217026D

deklarojmë se aktiviteti i shoqërisë “ALBKET”shpk, do të rregullohet, organizohet dhe zhvillohet në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

1) Ky Akt-Themelimi dhe Statuti bashkalidhur, janë përgatitur në bazë të kërkesave të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.

2) Kohëzgjatja e aktivitetit fiksohet për një periudhë kohe të pakufizuar.

3) Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

Eksport/Import i përkohshëm i mallrave ushtarake (panaire/ekspozita/teste/qëllime testimi/riparime/shërbime mirëmbajtje dhe qëllime të tjera të ngjashme)

Konsulencë, asistencë, përfaqësim ligjor dhe jo vetëm në marrëdhënie me Administratën Publike, BE-ne dhe NATO-n, me qëllim kërkimin, lëshimin e vërtetimeve, dokumentave të ndryshme, licencave, autorizimeve, lejeve apo çdo dokument tjetër të nevojshëm me qëllim përmbushjen e kërkesave të klientëve;

Pjesëmarrje në gara kombëtare/nderkombëtare si dhe thirrje të NATO-s apo institucioneve që varen prej saj me objekt shërbimet, ndërtimin, transportin dhe çdo aktivitet që lidhet me objektin dhe pikat e këtij statuti për fushën e mbrojtjes dhe atë civile.

Transferime kombëtare dhe nderkombëtare të mallrave ushtarake.

Transferime kombëtare dhe nderkombëtare të artikulave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë

Veprimtari ndërmjetësuese për mallra ushtarake dhe mallra të teknologji me përdorim të dyfishtë.

Trajnime në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes

Asistencë dhe konsulencë mbi politikën, programet dhe mundësitë e financimit lokal, kombëtar, evropian dhe ndërkombëtar në favor të individëve, shoqërive dhe enteve publike apo private;

Administrim, menaxhim, drejtim financiar, administrativ dhe organizativ të projekteve lokale, evropiane dhe jo evropiane të zhvillimit shoqëror dhe ekonomik, të bashkëpunimit territorial, të kërkimit shkencor dhe teknologjik, të eksperimentimit teknik edhe në ndihmë të individëve, shoqërive dhe enteve publike apo private;

Administrim, menaxhim, drejtim financiar, administrativ dhe organizativ të projekteve lokale, evropiane dhe NATO-s, në fushën ushtarake, të zhvillimit shoqëror dhe ekonomik, të bashkëpunimit territorial, të kërkimit shkencor dhe teknologjik, të eksperimentimit teknik edhe në ndihmë të individëve, shoqërive dhe enteve publike apo private;

Formim profesional në favor të individëve, shoqërive dhe enteve publike dhe private, drejtimin e formimit profesional, universitar dhe pas universitar, menaxherial dhe të specializuar në sektorë të ndryshëm me interes ekonomik, juridik, në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë si dhe social dhe shkencor;

Shoqëria mund të kryejë veprimtaritë e përshkruara nëpërmjet profesionistëve të licencuar për fushat të cilat janë kompetencë e tyre;

Asistentencë dhe konsulencë për kërkimin dhe identifikimin e tregjeve të reja, menaxhimin e inovacionit, gjetjen e financimeve, gjetjen e punonjësve, agjenci dhe ndërmjetësim në favor të individëve, shoqërive dhe enteve publike apo private, kërkime sociologjike, statistikore, sociodemografike, studime të tregut, rlevime dhe sondazhe zgjedhore.

Shoqëria mund të realizojë dhe marri pjese ne projekte ne fushen e ndertimit dhe sherbimeve për përdorimin e fondeve publike, të BE-së dhe NATO-s, duke përfshirë krijimin e rrjeteve dhe partneriteteve të ndyshme vëndase dhe të huaja;

Shoqëria ka si objektiv aktivitetet që lidhen me pasuritë e patundshme dhe të ndërtimit në përgjithësi.

- 4) **Selia e shoqërisë** Shoqëria e ka selinë e saj në adresën: Rr Komuna e Parisit, SH/K 4 AP 35, Zona kadastrale 8260 Nr pasurie 6/759+4-35 Tiranë;

5) **Kapitali themeltar** i shoqërisë përbëhet

Kapitali fillestarë i shoqërisë është i barabartë me 500.000 lekë (pesëqind mijë), i cili miratohet nga ortakët, dhe nuk është i derdhur nga ortakët themelues dhe ndahet në 2 kuota.

Kapitali është i ndarë mes ortakëve themelues si më poshtë:

- 1) Ortaku themelues Bekim PIREVA, mbajtës i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme nominale të barabartë 325.000 Lekë (treqindnjëzetepesë mijë), që përbën 65% (gjashtëdhjetë e pesë përqind) të kapitalit të shoqërisë.
 - 2) Ortaku themelues Gentian CANI, mbajtës i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme nominale të barabartë me 175.000 Lekë (njëqindeshtatëdhjetë e pesë mijë), që përbën 35% (.tridhjetë e pesë përqind) të kapitalit të shoqërisë.
- 6) **Administratori i shoqërisë**, emërohet për një periudhë kohe 5 (pesë) vjecare me të drejtë riemërimi është:

Gentian CANI, i lindur në Tiranë më 17.12.191972, shtetas Shqiptar, i identifikuar me Kartën e Identitetit nr.H21217026D.

Administratori gëzojnë kompetenca të pakufizuara për realizimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që janë ngarkuar asamblesë së përgjithshme.

Në përmbushje të detyrës së tyre mund të venë në lëvizje instanca juridike dhe administrative, duke emëruar avokatë e duke lëshuar prokura në raste gjyqesh, të kryejnë operacione bankare, përfshirë këtu edhe hapjen e llogarive rrjedhëse, nënshkrimin dhe

xhirimin e çeqeve, realizimin e terheqjeve dhe derdhjeve me lekë ne dorë apo urdhër-xhirmi, tituj krediti, paradhënie krediti.

Administratori në përfundim të cdo viti ekonomik përpilojnë një relacion mbi aktivitetin e zhvilluar, objektivat e arritura dhe perspektivën e shoqërisë, si dhe përgatisinin bilancin përfundimtar që ia paraqesin cdo vit Asamblesë për aprovim.

7) **Viti ekonomik** fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të cdo viti.

8) **Vlera e kontributit dhe kuotat e ortakëve** shënohen në një libër të posacëm të shoqërisë.

Në përfundim të vitit ekonomik, pas aprovimit të bilancit, Asambleja pasi ka ndarë fondet për likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve, detyrimet fiskale ndaj shtetit, rezervat e detyrueshme, vendos për ndarjen e fitimit neto. Për humbjet përgjigjet eskuzivisht shoqëria me kapitalin e saj.

9) **Ortakët** mund ta zmadhojnë kontributin e tyre dhe si pasojë edhe kuotën e tyre, duke depozituar fitimet e realizuara nga aktiviteti i shoqërisë, konform asaj së parashikuar në Statutin e shoqërisë.

10) **Ortakët dhe Administratori** janë të detyruar të ruajnë sekretin mbi dokumentacionin dhe të dhënat, njohuritë dhe eksperiencat e fituara gjatë aktivitetit të shoqërisë, dhe marrin të gjitha masat e nevojshme të sigurisë për të evituar përhapjen, qoftë edhe pjesërisht.

Ata janë përgjegjës për pasojat negative që mund të vijnë nga shkelja e dispozitës së mësipërme. Për sa cituar më lart vlen edhe për Ekspertin Kontabël të Regjistruar.

Ortakët janë përgjegjës, ndaj të tretëve për dëmet që mund t'u shkaktohen nga anullimi apo deklarimi i pavlefshëm i këtij akti themelues.

Për sa nuk specifikohet shprehimisht në këtë akt, vlejnë normat e Statutit bashkangjitur.

Njëkohësisht me nënshkrimin e këtij Akti, ortakët nënshkruajnë edhe Statutin e shoqërisë "**ALBKET**" shpk., i cili i bashkalidhet aktit të themelimit dhe është pjesë përbërëse e tij.



ORTAKËT E SHOQËRISË

“ALBKET” shpk

Bekim PIREVA

BEKIM PIREVA

A handwritten signature in blue ink, consisting of a stylized 'B' followed by a long horizontal stroke.

Gentian CANI

GENTIAN CANI

A handwritten signature in blue ink, featuring a stylized 'G' and 'C' with a long horizontal stroke extending to the right.